



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**

**DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN KOORDINIMIT DHE INFORMIMIT PUBLIK  
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK**

Nr. 830/ Prot.  
1.1

Patos, më 11.04 / 2022

**PROCES-VERBAL**

I mbajtur sot në datë 08.04.2022 ora 10:00 në ambientet e Njesisë Administrative Zharrëz Patos ku organizohet Takim konsultativ me përfaqësues të grupeve të interesit dhe fermerë lidhur mbi marrjen e mendimit për **“Krijimin e ambienteve për ofrimin e shërbimeve mbështetëse për fermerët e tij”**

Pjesëmarrës në këtë mbledhje janë:

1. Drejtoria Zhvillimit, Bujqësor, Blektoral, Pyjor, Mjedisit dhe Kontrollit të Ushqimit
2. Përfaqësues të Shoqërisë Civile
3. Kryetarë të fshatrave
4. Fermerë të zonës
5. Përfaqësues të ekzekutivit të Bashkisë

Takimi hapet nga Drejtori i Zhvillimit, Bujqësor, Blektoral, Pyjor, Mjedisit dhe Kontrollit z. Orges Gollosi.

Orges Gollosi – së pari unë dua t’ju falenderoj që gjetët kohën për të qenë pjesë e këtij takimi konsultativ. Siç dhe e dini bashkia përmes skemave mbështetëse të qeverisë është munduar të përkrah fermerët duke i orientuar drejt, për të përfituar sa më shumë përmes skemave të ndryshme. Pra me pak fjalë ne kërkojmë të dimë se cilat janë nevojat tuaja reale si fermer me qëllim që në bashkëpunim me Drejtorinë e Integrimit përmes aplikimeve të financimeve të jashtme të kemi mundësinë që përmes asistencave të ndryshme t’ju vijmë në ndihmë sadopak. Fjala është për ju.

Marigo Mahmuti – ne si drejtori kërkojmë që të krijojmë mundësinë që përmes fondeve dhe projekteve të huaja të ofrojmë asistencë për të ndihmuar fermerët në mënyrën se si ata mund të aplikojnë në një projekt apo edhe se si të aplikojnë në një skemë. Ka shumë programe brenda dhe jashtë vendit kryesisht për të cilat ne kemi mundësinë të aplikojmë dhe që kanë vlera të larta financimi.

Ferrik Grëmbi – përpara se ju të na ndihmoni në format e aplikimeve në skemat mbështetëse ju duhet të na ndihmoni ne si fermerë që të marrim dokumentin e pronësisë pasi është një nga kushtet kryesore për të aplikuar në një projekt për të përfituar më pas si fermerë në skema subvecionimi.

Marigo Mahmuti - kur ne themi se duam t'ju ndihmojmë nënkuptojmë se do t'ju krijojmë mundësinë të informoheni dhe të dini se cilat janë kriteret dhe shanset tuaja për të fituar një projekt. Ideja është që ne të krijojmë ura komunikimi brenda dhe jashtë vendit. Duam t'ju ndihmojmë duke ofruar shërbime më të mira dhe të përqëndruara në një pikë të vetme.

Agron Toto – ju kërkoni të na ndihmoni me aplikime në skema përfituese për fermerët?

Roland Xhepaj – ne do të na ndihmoni shumë nëse do të na jepej informacion për skemat ndihmëse

Vangjel Tereziu – do të ishte mirë që në njësinë Zharrëz të kishte një zyrë informacioni për fermerët

Ferrik Grëmbi – lidhur mbi ndihmën që ju kërkoni të na jepni si fillim ju duhet të përcaktoni një pikë referimi apo një vend të përcaktuar për të na orientuar më drejt në marrjen e informacionit si dhe **mungesa e një tregu** ka një ndikim të fortë në luhatjen e çmimit pasi ofertat e çmimeve vijnë vetëm nga blerësit dhe jo nga unë si fermer

Tajar Hoxha - Ferriku ka të drejtë pasi ne nuk aplikojnë dot në skema pa patur dokument pronësie gjithashtu ne kemi një problem të madh me shitjen e prodhimit tonë

Orges Gollosi – ndaj dhe ne jemi mbledhur sot për të parë dhe kuptuar drejt problemet tuaja reale si fermer me qëllim që të kemi mundësi për t'ju ndihmuar qoftë në aplikime në skema mbështetëse qoftë në përpilimin e projekteve të ndryshme.

Namik Plepi – keni informacion lidhur mbi azhornimin e tokës, pasi kjo pengon fermerët për të aplikuar mbi skemat e subvecionimit?

Orges Gollosi – ne si Bashki jemi në kontakt të vazhdueshëm me ASHK lidhur me pjesën e azhornimit të tokave bujqësore jo vetëm për Njësinë Zharrëz, por edhe për Njësinë Ruzhdie dhe Patosin.

Namik Plepi- një fermer pa asnjë të ardhur nuk mund ta punoj tokën pasi pesticidet janë tepër të shtrenjta dhe fermerët që kultivojnë sera nuk mund të shesin dot prodhimin e tyre. Jam dakord me dy parafolësit të cilët hodhën idenë e një zyre informacioni dhe do të ishte mirë që ju si Bashki të na ndihmoni për të qenë fitues në skemat e subvecionimit si ato kombëtare, ashtu dhe në ato lokale duke krijuar një zyrë informacioni ose një pikë kontakti në Njësinë Zharrëz ku ne të kemi mundësi të informohemi jo vetëm me plotësimin e dokumentacionit, por edhe me asistencën në aplikim e skemave përfituese apo hartimin e projekteve për aplikim.

Roland Xhepaj – kërkoi që të krijohet një pikë grumbullimi për mbledhjen e prodhimit të fermerëve.



Marigo Mahmuti – Mesa kuptova ju kërkoni që të krijohet një qendër informimi me specialistë të mirëfilltë të fushës ku në bazë të thirrjeve që vijnë për projekte të ndryshme për fermerët ju duhet të informoheni për të ditur sesi do të aplikoni për një projekt të caktuar? A di ndonjëri prej jush se si aplikohet nëpër programet e BE-së? A ka ndonjë që ka aplikuar më para dhe ka fituar?

Agron Doko – nëse ju do të mund ta krijoni mundësinë e krijimit të një zyre informacioni mendoj që ajo të jetë edhe një pikë takimi jo vetëm me fermerët e vegjël, por edhe me subjektet e mëdha me qëllim që ne të krijojmë ura kontakti për shitjen e prodhimeve tona.

Ferrik Rama – do të ishte mirë që kjo zyrë të jetë këtu te komuna me qëllim që të jetë sa më afër nesh pasi unë si fermer dua ta marr informacionin pranë qendrës sime të banimit.

Roland Xhepa – gjithashtu kjo zyrë duhet të ketë person të kualifikuar me qëllim që të na japi informacion të saktë.

Orges Gollosi – qëllimi i funksionimit të zyrës mesa kuptoj sipas propozimeve tuaja është jo vetëm dhënia e informacionit, por edhe ndihmesa në skemat mbështetëse kombëtare dhe lokale.

Ferrik Rama – unë shpresoj se nëse kjo zyrë nëse do të hapet pranë njësisë sonë jo vetëm unë, por edhe shumë fermerë të tjerë që kemi sera do të na jepet mundësia të krijojmë kontakte me biznesin e madh ose të rifitojmë kontaktet lidhëse me ta pasi me rënien e pandemisë dhe mbylljes së rrugëve për shitjen jashtë vendit prodhimi jonë ka shkuar në kanal i gjithi.

Liljana Demollaj - unë si fermere kam shitur prodhimin, por akoma e kësaj dite nuk kam marrë akoma pagesën ndaj dhe kjo zyrë duhet të ndërhyjë në negociata me bizneset që marrin prodhimin tonë për të mos lejuar shitjen e mallit në mënyrë informale, pa kontrata, mes fermerëve apo blerësve me shumicë, pasi në të kundërt unë jam e falimentuar.

Ferrik Rama – kërkuj që të vendoset një çmim standard për të gjithë fermerët.

Agron Doko – bashkia duhet të investojë për ndërtimin e një pike grumbullimi të prodhimeve tona gjithashtu duhet të ketë rolin e negociatorit për standartizimin e çmimeve

Roland Xhepa – kërkujmë që të ndërhyet në infrastrukturën rrugore për në parcela pasi nuk mundemi dot të shkojmë aty ku ndodhet prodhimi

Ymer Grëmbi – unë si fermer jam përmytur dy herë pasi nuk janë pastruar kanalet kullues dhe akoma nuk kam marrë dëmshpërblim

Agron Doko – kërkujmë që të jetë një zyrë për marrjen e ankesave për fermerët pasi nuk kam pse të shkoj në Patos për një ankesë gjithashtu kjo zyrë të na japi informacion dhe asistencë në plotësim dokumentacioni për cdo projekt subvencionimi.

Marigo Mahmuti – unë dua t'ju bëj një pyetje lidhur mbi forcën punëtore, kush i drejton punët tuaja si fermer? A keni forcë punëtore që ju ndihmon apo e keni të përqëndruar si biznes familjar? A ju ndihmojnë fëmijët?

Luan Hoxha – lidhur mbi fuqinë punëtore që ju po pyesni është shumë keq pasi të rinjtë po ikin dhe nuk po qëndron njeri

Në një anë kemi njerëz që ankohen për mungesë të tregut të punës, në një anë kemi biznese dhe fermerë që kërkojnë forcë pune.

Tajar Hoxha – po të bëhet pika e grumbullimit të prodhimit brenda standarteve evropiane do të ketë më shumë mënyra dhe mundësi për tu ofruar biznesi i madh.

Orges Gollosi – unë ju falenderoj për të gjitha mendimet e frytshme që dhatë deri tani. Nëse ndokush ka ndonjë propozim apo sugjerim tjetër? M.q.se jo edhe njëherë ju falenderoj që ishit prezent dhe përsëri mbetem i gjykimit që keni dhënë mendime të vyera.

**Koordinator**  
**Për Konsultimin Publik**  
**Suzana Hysenaj**







Zharrëz më, 08.04.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS


LISTË PREZENCË PËR TAKIMIN LIDHUR MBI MARRJEN E MENDIMIT PËR :

“KRIJIMIN E AMBIENTEVE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE MBËSHETËTËSE PËR FERMERËT”

Nr	Emër	Mbiemër	Qyteti /fshati	Profesioni/ Pozicion	Nr. Kontakti	Firma
1	Ligjan	Demolig	Zharrëz	Fermer		
2	Emrija	Memini	Zharrëz	Fermer	0694892756	
3	Almir	Kolaj	F. R.	Kryefaktor	069 24 52 994	
4	Ilmi	MYFTHARR	DUKËS	KRYETAR FARMACI	069 10 638	
5	Adri	Bregjeri	Ruzhica	Kryetar Fshati	06922 90891	
6	Arben	Alcal	Reris	Kryetar Fshati	0683557968	
7	Vangjel	Tershi	Zharrëz	Fermer		068242475
8	Apollon	Greshi	Shqipëri	K. Shqipëri	068 2105173	
9	Gratko	Zarfa	Frashev	K. Frashev	0694614825	
10	Yaqer	Hajdar	Zharrëz	Fermer	0683396974	
11	Arben	Orëni	K. F. Bërnë	K. Bërnë	0694753716	
12	Arbenol	Hajdar	Zharrëz	Fermer	069 8402733	
13	Agton	Deho	Zharrëz	Fermer	0695788733	

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008” Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale, Neni 10 “Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistikore” Të dhënat personale, të mbledhura për qëllime të tjera, mund të përpunohen më tej për qëllime shkencore ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ. Të dhënat personale të koduara përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin. Përpunimi i të dhënave personale përdoret vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike. Përfshihet nga zbatimi i neneve të ligjit.





Zharrëz më, 08.04.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS

LISTË PREZENCË PËR TAKIMIN LIDHUR MBI MARRJEN E MENDIMIT PËR :  
“KRIJIMIN E AMBIENTEVE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE MBËSHITËSE PËR FERMERËT”

Nr	Emër	Mbiemër	Qyteti /fshati	Profesioni/ Pozicion	Nr. Kontakti	Firma
1	Ferrik	Rama	Zharrëz	fermer	0695385382	
2	Ysmail	Hajaj	Zharrëz	fermer	0692671051	
3	Ymer	Çikëmbi	ZHARRËZ	Fermer	0692030379	
4	Poliheni	Tupa	Zharrëz	Administratore	0695725284	
5	Valbona	Semoviqaj	Sheqishtë	Përgjigjëse/kullim	6693665256	
6	Sajka	Golloshi	Patos	Rejg. Sek. Bujqësi	0693353202	
7	Suzana	Hyseni	Patos	Koordinator Konsultim	0694881460	
8	Albin	Çipriani	Patos	Koordinator Publik	0696200444	
9						
10						
11						
12						
13						

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008” Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale, Neni 10 “Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistike” Të dhënat personale, të mbledhura për çfarëdolloj qëllimi, mund të përpunohen më tej për qëllime shkencore ose statistike, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ. Të dhënat personale të koduara përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin. Përpunimi i të dhënave personale përdoret vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike. Përfashtohet nga zbatimi i neneve të kësaj ligjeje.